STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 14 mars 2013

**GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIMBURSIMIN FEDERAL PER FSHATIN E BRAJTUOTERS (BRIGHTWATERS) PER KOSTOT E SUPER STUHISE SENDI (SANDY)**

***Guvernatori drejton mbi 100,000 dollarë në fonde të miratuara nga FEMA tek Brajtuotërs (Brightwaters) për kostot e pastrimit pas super stuhisë Sendi (Sandy)***

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka siguruar 118,954 dollarë për Qytezën e Brajtuotërs (Brightwaters) në Qarkun Safolk (Suffolk County) për rimbursimin e kostove të pësuara nga Qyteza pas pasojave të super stuhisë Sendi (Sandy). Fshati i Brajtuotërs (Brightwaters) pësoi pemë dhe bimë të tjerë të dëmtuara rëndë, duke lënë rreth 1,821 jardë kub të mbeturinave në rrugët e fshatit. Fshati u përgjigj duke kombinuar personelin e fshatit, pajisjet dhe disa kontrata të jashtme. Kontratat u përdorën për pastrimin e mbeturinave, heqjen e pemëve, heqjen e plehrave dhe mbetjeve nga kopshtet dhe transportimin e mbeturinave në vendin e eleminimit.

"Ndikimi i Sendit (Sandy) ishte shkatërrues për çdo komunitet në rrugën e tij dhe Fshati i Brajtuotërs (Brightwaters) nuk ishte përjashtim," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Fshatit, si kaq shumë komuniteteve të tjera të prekura, iu desh të veprojë shpejt për të hequr mbeturinat që bllokuan kalimin dhe penguan çdo lëvizje përgjatë rrugëve të tij. Jam shumë i gëzuar të jem në gjendje që të drejtoj këto fonde përseri tek qyteza dhe t'i ndihmoj ata të vazhdojnë në përpjekjet e tyre të përgjithshme për rimëkëmbje."

Senatori Fil Bojl (Phil Boyle) tha: "Jam i gëzuar që fondet e FEMA-s janë duke iu dhënë Fshatit të Brajtuotërs (Brightwaters) për rimbursimin e kostove të pastrimit pas Sendit (Sandy) dhe falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për veprimin e shpejtë të tij në drejtimin e këtyre fondeve. Mezi pres që të punoj me FEMA-n dhe me Guvernatorin për të përshpejtuar që fonde të ngjashme t'u shpërndahen komuniteteve të tjera të goditura rëndë në zonën tonë."

Anëtari i asamblesë Endrju Garbarino (Andrew Garbarino) tha, "Në një kohë kur komunat vendore janë duke u përpjekur të mbulojnë kostot e tyre, dëshiroj të falënderoj Guvernatorin për sigurimin e fondeve mjaft të nevojshme të rimbursimit për kostot e papritura që pësoi Fshati i Brajtuotërs (Brightwaters) si rezultat i super stuhisë Sendi (Sandy)."

“Super stuhia Sendi (Sandy) detyroi të gjitha komunitetet e prekura që të reagojnë shpejt ndaj dëmit që shkaktoi, veçanërisht ndaj nevojës për të hequr sasi të mëdha të mbeturinave. Këto fonde të Ndihmës Publike do të ndihmojnë secilin nga komunitetet e prekura që të rivendosin në rregull punët fiskale të tyre,” tha Komisioneri i Seksionit të Sigurisë së Atdheut dhe Shërbimeve të Urgjencës të NYS-së (NYS Division of Homeland Security and Emergency Services Commisioner) Xherom M. Hauër (Jerome M. Hauer).

Dhënia e këtyre fondeve federale është pjesë e rimbursimeve në vazhdim dhe në pritje në të ardhmen që shteti do të administrojë dhe paguajë tek komunat e prekura. Komunat janë duke u rimbursuar mbështetur në një shumëllojshmëri projektesh që përfshijnë ndërtimin dhe shkatërrimin, heqjen e mbeturinave ranore dhe bimore, aktivizime të EOC-së, largime, kontrolle dhe riparime dhe rivendosje emergjente të teknologjisë së informacionit dhe programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (Sheltering and Temporary Essential Power) (STEP). Shteti do të vazhdojë t’i bëjë këto pagesa të rimbursimeve ndërsa FEMA jep fondet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418